



Funded by
the European Union



Udhëzues për përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore, gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese

Gjuha e ndjeshme gjinore është tejet e rëndësishme për të siguruar gjithëpërfshirjen dhe trajtimin me dinjitet të qytetarëve dhe qytetareve, stafit të komunës dhe aktorëve të tjerë. Tabela në vijim mund të shërbejë si listë kontrolli për politikën, rregulloret, dokumentet e brendshme, si dhe komunikimin me palë të tjera, direkt apo përmes rrjeteve sociale.

✓ PËRDORNI	X MOS PËRDORNI
<u>Përdorni</u> trajta që përfshijnë të gjitha gjinitë ose forma neutrale kur është e mundur. <u>Shembuj të mirë:</u> ✓ Punonjëset dhe punonjësit ✓ Qytetarët dhe qytetaret ✓ Personat në pozita udhëheqëse ✓ Çdo ditë, secili <u>qytetar dhe qytetare</u> duhet të pyesin veten <u>e tyre</u> se si mund të përmbushin detyrimet <u>e tyre</u> qytetare ✓ Aplikueset dhe aplikuesit janë të mirëseardhur ✓ Subvencionimi i fermerëve dhe fermereve	<u>Mos përdorni</u> gjininë mashkullore si standard universal <u>Shembuj jo të mirë:</u> - X Punonjësit - X Qytetarët - X Udhëheqësit/Drejtorët - X Çdo ditë, secili <u>qytetar</u> duhet të pyesë veten se si mund të përmbushë detyrimet <u>e tij</u> qytetare - X Kushdo që dëshiron të aplikojë, mund të paraqes aplikacionin <u>e tij</u> - X Subvencionimi i fermerëve
<u>Përdorni</u> tituj dhe emërtime gjinore të sakta <u>Shembuj të mirë:</u> ✓ Znj. Besa Gashi, Drejtoreshë ✓ Znj. Besa Gashi, Kryetare ✓ Znj. Besa Gashi, Ministre	<u>Mos përdorni</u> gjininë mashkullore të titullit apo pozitës, kur ajo pozitë mbahet nga gratë <u>Shembuj jo të mirë:</u> - X Znj. Besa Gashi, Drejtor - X Znj. Besa Gashi, Kryetar - X Znj. Besa Gashi, Ministër
<u>Përdorni</u> gjuhë gjithëpërfshirëse, pa stereotipe <u>Shembuj të mirë:</u> ✓ Ftojme gratë dhe burrat në dëgjimin publik për çerdhe ✓ Konkurs për asistent/e të drejtorit/eshës ✓ Trajnim për Kryetarët dhe Kryetaret e Këshillave Komunalë ✓ Gratë dhe burrat kanë pjekuri të mjaftueshme emocionale për të menaxhuar raste emergjente ✓ Gratë dhe burrat kontribuojnë dhe udhëheqin në mënyrë të barabartë	<u>Mos përdorni</u> stereotipe gjinore <u>Shembuj jo të mirë:</u> - X Ftojme përfaqëseueset e gjinisë së bukur në dëgjimin publik për çerdhe - X Konkurs për asistente të drejtorit - X Trajnim për Kryetarët e Këshillave Komunalë - X Gratë janë emocionale – nuk janë për menaxhim stresi në raste emergjente - X Burrat janë liderë natyralë

<u>Përdorni gjuhë që trajton gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë</u> <u>Shembuj të mirë:</u> ✓ Drejtori i departamentit të administratës, Z. Besnik Gashi, dhe Zyrtarja e Lartë e departamentit të administratës, Znj. Besa Gashi, morën pjesë në konferencë ✓ Znj. Besa Gashi (pavarësisht statusit civil) ✓ Do të caktojmë një anëtare të ekipit të komunikimit ✓ Të ftuar në ngjarje janë ambasadorët/et dhe partnerët e tyre. ✓ Gratë dhe burrat duhet të paguhen njëjtë për punën e njëjtë	<u>Mos përdorni gjuhë nënvlerësuese, diskriminuese dhe seksiste</u> <u>Shembuj jo të mirë:</u> - X Drejtori Z. Besnik Gashi dhe zyrtarja e departamentit të administratës morën pjesë në konferencë - X Znjsh. Besa Gashi - X Do të caktojmë një tërësi prej vajzave të Komunikimit të përgatisë komunikatën (termi vajzë nënvlerëson aftësitë profesionale) - X Të ftuar në ngjarje janë ambasadorët dhe gratë e tyre - X Gratë duhet të paguhen më pak se burrat sepse janë më pak të zgjuara
<u>Përdorni imazhe gjithëpërfshirëse në komunikimin vizual</u> <u>Shembuj të mirë:</u> ✓ Foto të mësuesve dhe mësueseve me nxënës të dy gjinive për të shënuar fillimin e vitit shkollor ✓ Foto të pjesëmarrësve burra dhe gra në takim të Këshillit Lokal ✓ Video të grave dhe burrave që u bëjnë ftesë të dy gjinive për kontrolla të mamografisë (edhe burrat mund të kenë kancer të gjirit, ndonëse sipas statistikave janë më pak të prekur) ✓ Foto të inspektorëve dhe inspektoreve duke punuar në teren ✓ Foto të ngjarjeve të balancuara, ku shihen personat në pozita udhëheqëse po aq sa të tjerët ✓ Paraqitni gra dhe burra në role të ndryshme dhe të barabarta (drejtor/eshë, inxhinier/e, teknik/e, qytetarë/e aktiv/e).	<u>Mos përdorni imazhe ku shumica janë të një gjinie</u> <u>Shembuj jo të mirë:</u> - X Foto të mësueseve me nxënës të dy gjinive për të shënuar fillimin e vitit shkollor - X Foto të pjesëmarrësve burra në takim të Këshillit Lokal - X Video të grave duke u bërë ftesë grave për të bërë kontrolla të mamografisë - X Foto të inspektorëve duke punuar në teren - X Foto që fokus kanë vetëm personat në pozita udhëheqëse, duke lënë stafin, qytetarët dhe qytetaret, dhe aktorët tjerë si më pak të rëndësishëm - X Foto të burrave në diskutime për siguri, foto të grave infermiere

Keni parasysh: Ju mund të përdorni edhe gjuhë neutrale duke përdorur gjininë mashkullore kur flisni në shumës (shembull: qytetarët, kandidatët, nxënësit). Kjo formë nuk është gabim, por nuk është gjithëpërfshirëse. Për këtë arsye, edhe në këto raste, rekomandohet përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore (shembull: qytetarët dhe qytetaret, kandidatët dhe kandidatet, nxënësit dhe nxënëset).